

Rinia në udhëkryq, cila është rruga ?!

Rinia në udhëkryq, cila është rruga ?!

Ky botim u realizua nga OJQ Make A Difference (M.A.D.) përkrahur nga Friedrich-Ebert-Stiftung (FES)

Ekipi i botimit:

Sadri Rrmoku, Koordinator Projekti;

Pajtim Zeqiri, Asistent;

Alban Shabani, Hulumtues;

Egzon Krasniqi, Mbikqyrja finale

Shtypi: **Studio FORMA**

Dizajni i kopertinës: **Studio FORMA**

Pikëpamjet e paraqitura në këtë publikim janë të autorit-autorëve, dhe nuk paraqesin domosdoshmërisht pikëpamjet e Friedrich-Ebert-Stiftung.

Përmbajtja:

Analiza e kontekstit.....	4
Hyrje.....	5
Metodologjia.....	6
Target Grupet.....	6
Kapitulli I	7
Institucionet v.s Rinia.....	7
Politikat rinore ad-hoc	7
Rinia spektatore apo kreative e politikave?!.....	8
Institucionet me buxhete të fragmetarizuara.....	9
Kapitulli II	11
Mekanizmat rinore dhe Interesimi	11
Edukimit jo-fomal.....	11
Pjesëmarrja	11
Kapitulli III	15
Pjesëmarrja vs Pengesat	15
Kapitulli IV	17
Konkluzionet	17
Rekomandimet.....	18

Analiza e kontekstit

Margjinalizimi i prodhuar në Kosovës për gjatë viteve të 90', përjashtimi nga institucionet publike dhe vendim-marrja ishin domosdoshmëri për ndërtimin e një sistemi paralel institucional. Ky lloj i organizimit përfshinte sistemin e financimit, edukimit, shëndetësisë dhe aspektet socio-ekonomike¹. Organizimi si i tillë më tepër ka qenë i shtyrë nga solidariteti organik, si nevojë e mbijetesës dhe mbajtjes gjallë të institucioneve vitale.

Me vendosjen e bashkësisë ndërkombëtare në Kosovë fillon një fazë e re, ajo e rindërtimit dhe krijimit të institucioneve të përkohshme vetë-qeverisëse. Po në këtë kohë formësohet edhe koncepti i pjesëmarrjes së qytetarëve në politik-bërje dhe vendim-marrje, kryesisht përmes organizimit në organizata jo-qeveritare. Megjithatë ky aspekt nuk e kishte fokusin e veçantë, pavarësisht numrave dhe statistikave që tregonin rreth themelimit dhe organizimit në OJQ lokale. Ky proces si i tillë në masë të madhe është përcjellë më shumë mangësi pa ndonjë agjendë të qartë institucionale dhe për rrjedhojë ka lënë hapësirë që shumë organizata ndërkombëtare dhe vendore të lënë një shije të keqe tek publiku, për të mos thënë ka bërë një dëm të pariparueshëm të raportit qytetar - shoqëri civile.

Procesi i shtet-ndërtimit dhe demokratizimit në tërësi pothuajse ka kaluar në akomodimin e pakicave, e shumë më pak në ndërtimin e një shoqërie të hapur, demokratike dhe të barabartë. Nëse e shohim formësimin institucional të nivelit të parë qeverisës (komunave) si platforma kryesore e komunikimit, konsultimit, pjesëmarrjes së qytetarëve në vendim-marrje, monitorim dhe mbikëqyrje, ky bazament më tepër është fokusuar në rrafshin politik në raport me komunitet e në masë shumë të vogël me bërjen hisedar të publikut në vendim-marrje. Shtu këtu edhe faktin e integritit të një administrate e cila ka kaluar nëpër një tranzicion të vështirë ekonomik, politik dhe institucional. Marrë parasysh se përgjatë vitet e 90' kanë ndodhur reformat më të mëdha sa i përket koncepteve qeverisëse duke përfshirë edhe qeverisjen e mirë si nocion. Banka botërore e definon qeverisjen e mirë si sinonim me menaxhmentin zhvillimor. Me fjalë të tjera, qeverisja e mirë është shtyllë qendrore në krijimin dhe mirëmbajtjen e një mjedisi që fuqizon zhvillimin e drejtë.²

Nëse e shohim këtë historik të shkurtër mund të konsiderohet se pjesëmarrja e dobët dhe humbja e besimit të qytetarëve në vendim-marrje janë në korrelacion të drejtë me formësimin institucional dhe kulturën politike. Para se gjithash është pasojë e mungesës së një kontratë sociale ku qytetarin do ta kthente në pjesë aktive në vendim-marrje. Kjo do të mund të ndodhë vetëm atëherë kur qytetari është hisedar direkt duke u nisur nga formësimi i politikave deri të zbatimi i tyre, në mënyrë që këto politika të kthehen në ngritje të mirëqenies.

¹ Juda, Tim (2008). *Kosovo: What everyone needs to know*. New York: Oxford University Press. Page: 71.

² Raporti i Bankës Botërore (1992). *Qeverisja e mirë dhe zhvillimi*. New York: Banka Botërore.

Hyrje

Republika e Kosovës, në frymën e saj të ndërtimit Kushtetues njeh, promovon dhe mbron të drejtën për pjesëmarrje në disa trajta. Këto të drejta garantohen dhe mbrohen në kapitullin e dytë (II), më specifikisht në nenet 40-45³.

Këto të drejta dhe obligime kanë derivuar në legjislacionin primar dhe sekondar, theks i veçantë u është dhënë në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, kjo bazuar në atë se Kosova ka një sistem një-shkallës qeverisës, niveli lokal është mjedisi i pare ku qytetari ballafaqohet me institucionin dhe merr shërbimin.⁴ Ligji për Vetëqeverisje Lokale në kreun e nëntë (IX) trajton demokracinë e drejtpërdrejtë dhe mekanizmat për pjesëmarrjen e qytetarëve⁵. Po-ashtu ekziston edhe rregullativa përcjellëse, statutet komunale dhe rregulloret komunale për këtë fushë.

Institucionet e Republikës së Kosovës, duke parë se niveli lokale ka mbetur brenda kornizave të trajtimit bazik ligjorë, ato kanë hartuar dhe legjislacion sekondar për kategori të veçanta në rastin në fjalë për rininë. Ku nëpërmjet Ligjit për Fuqizimin dhe Pjesëmarrjen e Rinisë⁶, saktësohen qartë roli i komunave, mekanizmat dhe format e rritjes së pjesëmarrjes së të rinjve në vendim-marrje publike.

Pavarësisht se ekziston një kuadër i qëndrueshëm rregullativ, pjesëmarrja e qytetarëve në vendim-marrje publike me theks e të rinjve ende vazhdon të jetë e dobët dhe kryesisht trajtohet në rrafshin formal të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale. Institucionet komunale ende funksionojnë me mekanizma të dobët të koordinimit, organizimit dhe fuqizimit të rinisë. Kjo pavarësisht përpjekjeve të vazhdueshme të ministrisë dhe sektorëve specifik në kuadër të komunave.

Mund të konstatohet se komunat kanë bërë progres të ngadalshëm në formësimin e institucioneve të përfaqësimit të rinisë siç janë këshillat e veprimt lokal rinor (KVLR) dhe qendrave rinore⁷. Por të dyja këto institucione vazhdojnë të operojnë pa buxhet, pa qëndrueshmëri në resurse, pa plane operacionale e me theks pa një rol të qartë në rritjen dhe fuqizimin e pjesëmarrjes së të rinjve në vendim-marrje publike. Pavarësisht se ekzistojnë disa invicitiva të ndërtuara kryesisht ad-hoc të takimeve konsultative në mes këtyre mekanizmave dhe institucioneve komunale, megjithatë ende nuk shihet një plan i qëndrueshëm dhe koheziv i fuqizimit dhe pjesëmarrjes.

Duke përdorur metodën krahasuese në mes të dhënave kuantitative dhe intervistave me zyrat për informim shohim se ekziston një hendek në mes informimit dhe pjesëmarrjes së të rinjve në vendim-marrje.

Kjo mund të jetë edhe rezultat se debatet publike kryesisht trajton aspektet e përgjithshme të qeverisjes, e shumë më pak temat e fokusuara për rininë. Parë nga rezultatet të rinjtë do të ishin shumë më të gatshëm të merrnin pjesë nëse do të diskutoheshin temat e fokusuara që prekin ata direkt nisur

³ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, kapitulli II, nenet 40-45

⁴ Tahiri Besnik, konferenca periodike për qeverisje lokale

⁵ http://www.gazetazyrtare.com/e-gov/index.php?option=com_content&task=view&id=147&Itemid=56&lang=sq

⁶ http://www.mkrs-ks.org/repository/docs/Ligji_03-L-145_per_Fuqizim_dhe_Pjesemarrje_te_Rinise.pdf

⁷ Po aty

nga: çështjet që lidhen me shkollimin (bursat), ato të përgjithshme të aktiviteteve kulturo-sportive e deri tek çështjet që lidhen direkt me mënyrat e punësimit.

Të dhënat hulumtuese nxjerrin edhe kontradikta të mëdha në mes të rëndësisë së pjesëmarrjes në debate publike dhe pjesëmarrjes së tyre reale në debatet e thirrura nga institucionet lokale.

Metodologjia

Në hulumtim janë trajtuar aspektet nga ato të përgjithshme deri tek ato të veçanta, nëpërmes një metodologjie kualitative, duke përdorur teorinë e bihovealizmit (ndërtimit institucional) aspektet krahasuese dhe kualitetin e pjesëmarrjes. Po ashtu janë marrë mostra nga anketimi me metodologjinë e rastit, ku ato kanë shërbyer si mjete provokuese dhe mjete pune për hulumtuesit.

Hulumtimi, pikënisje ka pasur në analizë të fokusuar të bazës ligjore të pjesëmarrjes së qytetarëve, formatin e organizimit të diskutimeve publike dhe parasëgjithash kualitetin e komunikimit të institucioneve lokale me të rinjtë. Analiza me theks të veçantë ka trajnuar rolin e mekanizmave institucional në përfaqësim dhe avokim, grupet e marginalizuara, grupet e interesit dhe komunitetet lokale specifikiisht të rinjve.

Vetë analiza është një ballafaqim i argumenteve në mes të informatave të dala nga institucionet, qytetarët dhe akterët tjerë që veprojnë në nivelin lokal. Kjo është provuar nëpërmes indikatorëve të vlerësohet pozicionimi i qytetarëve në raport me interesin e tyre për tematikat që trajtohen në komunë. Ky hulumtim është një përpjekje për të ofruar një përgjigjeje lidhur me interesimit qytetarë për pjesëmarrje në vendim-marrje me theks të rinjve.

Target Grupet

Grupi kryesor i synuar kanë qenë të rinjtë e moshës 15-24 vjeç, ky grup është trajtuar me fokus duke pasur parasysh se edhe vetë Ligji për Pjesëmarrjen dhe Fuqizimin e Rinisë⁸ e targeton këtë katagrori si të rinj. Në fokus analizë është trajtuar roli i institucioneve Komunale që kanë në portofolio çështjet e rinisë në këtë rast Drejtoritë për Kulturë, Rini dhe Sport. Po ashtu hulumtimi është bazuar në të dhënat paraprake me punën me qendrat rinore të regjionit të Prishtinës.

Ndërkaq aspekt i ndarë kanë qenë zyrat komunal për informim, si përgjegjëse njoftimin e publikut për debate komunale. Aspekt tjetër i trajtimit kanë qenë grupet e marginalizuara me theks personat me nevoja të veçanta.

Hulumtimi është zhvilluar në periudhën kohore mars – korrik 2016, në komunat e regjionit të Prishtinës (Prishtinë, Podujevë, Obiliq dhe Fushë Kosovë).

⁸ http://www.mkr-ks.org/repository/docs/Ligji_03-L-145_per_Fuqizim_dhe_Pjesemarrje_te_Rinise.pdf

Kapitulli I

Institucionet v.s Rinia

Kosova me kornizën e saj rregullative ka paraparë mekanizma ligjore dhe institucional për përkrahjen, fuqizimin dhe integrimin e rinisë. Në të dyja nivelet e qeverisjes atë qendrore dhe lokale, ndahen buxhete në formë grandesh dhe subvencionesh për këtë kategori⁹. Duhet theksuar se qasja ndaj rinisë qoftë nga niveli qendror apo ai lokal, është e shkëputur, e pa harmonizuar si e tillë rrezikon një rritje dhe zhvillim të qëndrueshëm të politikave rinore.

Parë në rrafshin e strukturave dhe aspekteve financiare ekzistojnë mekanizma rinore dhe mjete financiare solide për fuqizim dhe shtrirje të politikave rinore. Por hendeku paraqitet në mungesë të një harte vjetore të planifikimit të aktiviteteve nga dyja nivelet. Andaj një sistem i integruar i planifikimit do të shmangte në mënyrë të ndjeshme copëzimin e politikave dhe buxheteve. Kjo në masë do të lehtësonte edhe orientimin e fondeve të donatorëve për rini.

Pra në këtë aspekt shfaqen tri sfida kryesore, që secila ndër-vepron me tjetrën dhe në forma të ndryshme shtresëzojnë problemet në fuqizimin dhe pjesëmarrjen e rinisë.

- E para, ndërlidhet me një plani të integruar të përbashkët nacional në mes komunave dhe MKRS dhe ministrive dhe sektorëve tjerë që prekin drejtpërsëdrejti rininë;
- E dyta, ka të bëjë me një hartë të qartë të ndër-veprimit të mekanizmave institucional, organizatave vendore dhe ndërkombëtare në arritjen e objektivave të planit nacional dhe planeve operacionale;
- E treta, ndërlidhet me zbritjen e financave nga MKRS tek komunat apo ndërtimin e një mekanizmi të pavarur për ndarjen e subvencioneve.

Politikat rinore ad-hoc

Pavarësisht progresit të bërë në hartimin e rregullativës që derivon nga Ligji për Pjesëmarrje dhe Fuqizim të Rinisë (licencimi i qendrave rinore¹⁰; punën vullnetare dhe edukimin jo-formal¹¹), porë në rrafshin praktik progresi është tejet i ngadalshëm dhe po përcjelljet me paqartësi të mëdha për mënyrën e implementimit.

Ekziston një shkëputje në mes dikasterit për rini në MKRS dhe zyrtarëve komunal për rini, përveç takimeve formale, në teren nuk shihet veprime konkrete, kjo shkëputje thellohet edhe më tepër në planin e dytë të komunikimit në mes zyrtarëve për rini dhe mekanizmave rinorë në komuna.

Përgjatë këtyre viteve është parë se vetëm një aktivitet vjetor koordinohet në mes MKRS dhe sektorit rinor komunal, është fjala për ditët e rinisë, edhe pse vërehen shpesh mangësi në realizimin e këtij aktiviteti vjetor.¹²

⁹ <http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/05-L-071%20sh.pdf>

¹⁰ http://www.mkrs-ks.org/repository/docs/U.A._Nr._11-2010_per_regjistrimin_e_Qendrave_Rinore.pdf

¹¹ http://www.mkrs-ks.org/repository/docs/JA_04-2015_per_edukimin_joformal_te_te_rinjve.pdf

¹² <http://botasot.info/kultura/448419/mkrs-me-aktivitete-ne-lipjan-nis-ditet-e-rinise-2015/>

Parë nga këto, politikat rinore komunale kryesisht varen nga incentivat individuale të zyrtarëve për rini pranë DKRS-ve dhe drejtuesve të KVRL-ve dhe Qendrave Rinore. Duhet theksuar se këto të fundit janë plotësisht të mangëta në aspektin e kapaciteteve profesionale, financiare dhe operacionale. Zyrtarët për Rini në shumicën prej komunave janë pjesë e një stafi që ka kaluar në fazën e tranzicionit të viteve të 90',¹³ si të tillë nuk përfaqësojnë ndjeshëm një qasje pro-aktive të menaxhimit.¹⁴

Ndërkaq në KVRL-të dhe qendrat rinore, pas çdo kalimi të mandatit ndodh një shkëputje e plotë në mungesë të një strukture profesionale të vazhdueshme¹⁵. Si pasojë e kësaj duhet fokus dhe energji shtesë në përzgjedhjen e tyre bazuar në vizionet dhe planet e tyre vjetore. Deri më tani praktikata e ndjekura nuk përfaqësojnë një vlerësim të bazuar plotësisht në kritere dhe merita, por njihen si procese të ndikuara të favorizimit të grupeve të caktuara duke mos u larguar edhe nga praktikata e ndikimit politik dhe klientelist.

Rinia spektatore apo kreative e politikave?!

Në gjithë ciklin e hartimit të politikave qofshin nacionale apo komunale, pavarësisht mekanizmave rinorë siç janë Këshilli Qendror i Veprimit Rinore (KQVR) apo Këshillave të Veprimit Rinor Lokal (KVRL)¹⁶, politikata që prekin rininë qofshin përmes institucioneve të linjës apo atyre sektoriale, nuk kalojnë nëpërmes duarve të tyre. Nisur nga dizajnimi, planifikimi apo implementimi këto dy mekanizma përveç në disa raste kur shërbejnë si dekor, nuk kanë ndonjë rol të theksuar, si pasojë e kësaj të rinjtë nuk ndihen ende hisedar të këtyre politikave.

Madje këto institucione pavarësisht se të rinjtë i trajtojnë si kategori e veçantë për përfshirje sociale, nga praktika shihet se dizajnimi i politikave kalon në shabllone dhe me fokus në përmbushjen e obligimeve ligjore e shumë më pak në involvim përmbajtësor. Kjo shihet qartë edhe tek debatet publike komunale ku nuk ekzistojnë praktika serioze për debate të fokusuar lidhur me politikata rinore.

Megjithatë duhet theksuar se ka një progres në aspektin e përkrahjes për grupet e marginalizuara ku preken edhe një kategori e veçantë e të rinjve, me specifikisht kategoritë e personave me nevoja të veçanta, ku nëpërmjet subvencioneve nga Drejtoritë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale janë përkrahur aktivitetet e organizatave siç është HANDIKOS¹⁷. Pavarësisht kësaj ende nuk ekziston një plan i qartë për kontraktimin e shërbimeve dhe fuzionimin e aktiviteteve të këtyre kategorive me DKRS-të dhe Qendrat Rinore.

¹³ Intervista me drejtorët e DKRS-ve (Agron Gerguri - Podujevë, Fitore Hashani - Obiliq), dhe qershor 2016

¹⁴ Raporti i Bankës Botërore (1992). Qeverisja e mirë dhe zhvillimi. New York: Banka Botërore

¹⁵ <http://www.osce.org/sq/kosovo/110055?download=true>

¹⁶ http://www.mkrs-ks.org/repository/docs/Ligji_03-L-145_per_Fuqizim_dhe_Pjesemarrje_te_Rinise.pdf

¹⁷ <http://koha.net/?id=9&l=43829> - Komuna ndihmon veprimtarinë e "Handikosit" me 14 mijë euro

Institucionet me buxhete të fragmetarizuara

Bazuar në Ligjin për Fuqizimin e Rinisë, institucionet qendrore janë përgjegjëse për hartimin e rregullativës, programeve, procedurave, këmbimet ndërkombëtare dhe strukturave që ndër-lidhin ato me institucionet qendrore.¹⁸

Ndërkaq institucioneve komunale u bie barra kryesore duke u nisur nga themelimi i mekanizmave rinorë, hapësirave, financave e deri tek mbështetja e programeve.¹⁹ Përderisa komunat janë përgjegjëset kryesore për zbatimin e Ligjit, resurset financiare dhe kapacitetet kryesore profesionale dhe operacionale mbesin në nivelin qendrorë.

Në hapat e parë për mekanizmat rinore në disa fusha (hapësira, trajnime dhe fonde) ka pasur një përkrahje më të gjerë të organizatave ndërkombëtare siç janë organizata Gjermane GiZ programi për rini EDYK²⁰, dhe programe të organizatave tjera vendore e ndërkombëtare. Tani më ky rol është zbehur në masë dhe këto mekanizma kanë mbetur plotësisht në pritje të përkrahjes nga institucionet qendrore dhe lokale.

Vetëm Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit në buxhetin e saj për disa fusha rinore (Mbrotjtja dhe Integrimi i Rinisë; Zhvillimi dhe Përkrahja e Rinisë; Zhvillimi i Politikave Integruese) ka të planifikuara 800 mijë euro²¹.

Këto mjete në tërësi menaxhohen nga MKRS, dhe subjektet rinore këto mjete i marrin nëpërmjet aplikimit në thirrje për projekte. Por ende mbetet e paqartë, se cila është ndërlidhja e këtyre projekteve me objektivat ligjore dhe nevojat reale të të rinjve. Për më shumë qasja e komunave në këto fonde është plotësisht e shkapëputur, e për rrjedhojë ky intervenim nuk pasqyrojnë nevojat që burojnë nga poshtë-lartë dhe si të tilla nuk janë në përputhje me zhvillim të barabartë dhe koheziv të politikave rinore.

Parë buxhetet komunale, vetëm në komunat e regjionit të Prishtinës (Prishtinë, Podujevë, Obiliq dhe Fushë Kosovës) në kategoritë për subvencione dhe transfere për kulturë, rini dhe sport janë të planifikuara mbi 600 mijë euro.²² Duhet theksuar se kjo shumë është totali i buxhetit për të gjitha kategoritë që hyjnë në kuadër të DKRS-ve.

Është e rëndësishme të theksohet se një shumë solide e këtyre mjeteve u ndahet qendrave rinore dhe grupeve tjera rinore, bazuar në planet vjetore të tyre të punës. Parë nga viti paraprak 2015 në tri komuna (Podujevë, Obiliq dhe Fushë Kosovë) shumta e ndara kanë qenë nga 3 mijë - deri 10 mijë euro.²³ Këtu nuk përfshihet komuna e Prishtinës e cila për vitin 2016 në kategoritë subvencione dhe transfere për DKRS ka të ndara 516, 810 euro, ndërkaq në një kategori të veçantë janë përfshirë rinia

¹⁸ Ligji për Pjesëmarrje dhe Fuqizimin e Rinisë – Obligimet e Institucioneve qendrore

¹⁹ Ligji për Pjesëmarrje dhe Fuqizimin e Rinisë – Obligimet e institucioneve lokale

²⁰ <http://komunat-ks.net/punetoria-ne-boge-mbi-strategjine-e-edykgiz-pas-perfundimit-te-projektit/>

²¹ <http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/05-L-071%20sh.pdf>

²² <http://www.institutigap.org/spendings/#/~/~buxheti-i-kosoves----planifikimet>

²³ Intervista me drejtorët e DKRS-ve (Agron Gerguri - Podujevë, Fitore Hashani - Obiliq), dhe qershor 2016

dhe sporti me 256 mijë euro. ²⁴Pavarësisht se në intervista të strukturuar është provuar të nxirren të dhëna më të sakta për mjetet e ndara vetëm për rini, kjo nuk është arritur ngase këto nuk janë të ndara në kode të veçanta.

Ndarja e subvencioneve, pavarësisht thirrjeve, ende vazhdon të jetë një proces i mbyllur dhe jo mjaftueshëm transparent. Komunitetet ende nuk kanë ndonjë mekanizëm të pavarur për ndarjen e këtyre mjeteve, bazuar në kritere të përcaktuara paraprakisht.

²⁴ Raporti 3 mujor i shpenzimeve (janar-mars 2016), komuna e Prishtinës

Kapitulli II


Mekanizmat rinore dhe Interesimi

Edukimit jo-fomal

Në rast se e trajtojmë edukimin jo-fomal, shihet se organizatat dhe grupet rinore përgjatë këtyre viteve kanë kaluar nëpër seri të ndryshme trajnimesh dhe programesh. Megjithatë tani ky proces është rregulluar edhe në aspektin ligjorë nëpërmes udhëzimit administrativ të MKRS për edukimin jo-fomal.²⁵

Pavarësisht avancimit në shumë fusha, jo gjithnjë ky proces ka kaluar nëpër një koordinim të mjaftueshëm. Shpesh trajnimet të shkurtëra dhe pa kurikula të qarta kanë ndikuar në krijimin e një perceptimi negativ, duke dëmtuar në masë rolin e edukimit jo-fomal. Duhet theksuar se me kalimin e fazës emergjente, kohës së fundit interesi i donatorëve në këto fusha ka rënë ndjeshëm. Andaj është i domosdoshëm fuqizimi i strukturave rinore të përcaktuara me ligj për ta përbushur vakumin e krijuar.

Nga anketimi i nxjerrë në pyetjen se a është duke bërë mjaftueshëm komuna juaj në fuqizimin e rinisë, 18% e respondentëve nuk pajtohen aspak, 36% nuk pajtohen, 17% nuk kanë opinion, ndërkaq vetëm 22% pajtohen pjesërisht; e përqindjen më të vogël zënë ata që pajtohen me vetëm 7%. Shih figurën 1.



Pjesëmarrja

Trajtuar në aspektin e përgjithshëm të pjesëmarrjes së të rinjve në debatet publike komunale, bazuar në të dhënat e dala nga intervistat me zyrtarët komunal mund të konstatohet se në aspektin formal ligjorë komunat (ekzekutivi) përbushin obligimet për dy takime (debate) dhe takimet e veçanta për buxhet. Megjithatë mund të konkludohet se ende nuk ka shumë praktika sa u përket debateve të fokusuara me rini apo grupe tjera të veçanta. Ndërkaq mangësia më e madhe paraqitet tek takimet e të zgjedhurve komunal (këshilltarëve) me fokus grupe, madje shumica e komunave ende nuk kanë arritur ti funksionalizojnë komitetet jo-obligative shembull (arsim, rini, shëndeti etj) dhe komitetet konsultative (profesionale). Pra vërehet një shkëputje e plotë në mes të të zgjedhurve dhe qytetarëve.

²⁵ http://www.mkrs-ks.org/repository/docs/UA_04-2015_per_edukimin_joyformal_te_te_rinjve.pdf


Komunat, përdorin një seri mjetesh për informim (mediat lokale; faqet zyrtare, poster, rrjetet sociale; këshillat lokale etj), po ashtu vërehet interesim për bashkëpunim me organizatat rinore, megjithatë pritet që iniciativat të burojnë nga ata për temat që kanë interes të trajtojnë.²⁶ Ka iniciative edhe për të gjetur forma që do të ishin më produktive në raport me rritjen e pjesëmarrjes së të rinjve në debate publike.²⁷

Komunat kanë provuar të gjejnë edhe forma tjera të informimit sikur nëpërmjet postës dhe mesazheve telefonike, tek e para shfaqet problemi i mungesës së buxhetit të veçantë, ndërsa tek mesazhet del problemi se nuk ekziston një regjistër i numrave që përcakton lagjen.²⁸

Problematik e veçantë del edhe tek niveli nën-komunal (bashkësitë lokale) ku ata ende operojnë pa buxhete dhe kapacitete. Aspekt tjetër është mungesa e qasjes pro-aktive dhe inovative të drejtuesve të këtyre këshillave. Ka edhe praktika të mira kur presioni i bashkësive lokale ka shtyrë komunën të ndër marr veprime konkrete në ato lagje (rregullimi i parkut, hapësira për çerdhe etj).²⁹

Ekzistojnë shembuj, kur thirrja për debate publike bëhet derë më derë, nga këshillat lokal dhe se interesimi i shtuar për pjesëmarrje shfaqet në rastin e hartimit të buxheteve komunale.³⁰ Duhet theksuar se përkundër informimit të zyrave për komunikim me publikun brenda komunave, të rinjtë ende mbeten të pa informuar në lidhje me organizimin dhe mbajtjen e debateve publike.

Në pyetjen se a jeni të informuar për debatet publike, 34% të respondentëve shprehen se janë të informuar pjesërisht, 14% janë të informuar, 14% nuk janë të informuar, 7% nuk janë të informuar aspak, ndërsa 31% nuk kanë opinion. Shih figurën 2.



Pavarësisht numrit të ulët të pjesëmarrjes së të rinjve në debate publike është perceptim i përgjithshëm se ata duhet të marrin pjesë në debate publike. Ky është indikator pozitiv sa i përket rritjes së

²⁶ Gimolli Bujar, zyrtar për komunikim me publikun – Podujevë, intervistë më datë 16.05.2016

²⁷ Po aty


²⁸ Pacolli Fitore, shefe e kabinetit të kryetarit – Prishtinë, intervistë më datë 13.05.2016

²⁹ Po aty

³⁰ Haliti Adem, zyrtar për komunikim me publikun – Obiliq, intervistë më datë 23.03.2016


perceptimit për pjesëmarrje në debate, megjithatë dokumenti në vijim do të provoj të japë përgjigjeje se ku janë hendeqet kryesore.

Në pyetjen se a duhet rinia të marrë pjesë në debatet që zhvillohen në komunën e tyre, 77% e respondentëve pajtohen plotësisht, 18% pajtohen pjesërisht dhe vetëm 5% nuk kanë opinion. Duhet theksuar se opinioni negativ nuk ekziston në këtë përgjigjeje. Shih figurën 3.




Po ashtu ekziston perceptimi i lartë se pjesëmarrja e rinisë në debate publike do të ndikonte në rritjen e rolit të tyre në vendim-marrje.

Në pyetjen se a do të ndikonte pjesëmarrja më e madhe e të rinjve në debate komunale në rritjen e ndikimit në vendim-marrje, 59% e respondentëve kanë opinion pozitiv, 33% pajtohen pjesërisht, 5% nuk kanë opinion dhe vetëm 3% kanë opinion negativ. Shih figurën 4.



Në korrelacionin në mes perceptimit për rolin e të rinjve në vend-marrje dhe pjesëmarrjes reale të tyre në debate publike shfaqet një kontradiktë e madhe. Përderisa në pyetjet se a duhet të marrë rinia pjesë në debate publike dhe se a do të rriste rolin e tyre pjesëmarrja ku mbi 80% të opinionit ishte pozitiv, nëse e shohim pjesëmarrjen e tyre reale na del se mbi 60% kanë shprehur opinion negativ.

Nga të dhënat kuantitative në pyetjen sa shpesh merrni pjesë në debate publike, 23% deklarohen se nuk marrin pjesë asnjëherë, 40% deklarohen se marrin pjesë rrallë, 9% s'kanë opinion 25% marrin pjesë herë pas here, 3% marrin pjesë çdo herë. Shih figurën 5.



Kapitulli III

Pjesëmarrja vs Pengesat

Parë nga rezultatet paraprake duhet të trajtohet aspekti se sa afër dhe larg janë institucione dhe rinia. Ky kapitull do të pasqyroj disa nga dimensionet kryesore mbi të cilat të rinjtë shprehin interes më të madh, cili është niveli i kënaqshmërisë së të rinjve me institucionet komunale dhe cili është perceptimi i tyre se sa merren parasysh shqetësimet e tyre nga këto institucione.

Problemet mbi të cilat të rinjtë mendojnë se institucionet qendrore/lokale duhet të fokusohen, janë të grupuara në tri aspekte: promovimi, edukimi dhe punësimi.³¹ Të dhënat e përmbledhura dalin nga anketimi nëpërmes disa pyetjeve të hapura lidhur me shqetësimet kryesore dhe temat që duhet të trajtohen me prioritet nga institucionet.

Promovimi: në këtë aspekt të rinjtë shprehen të pa kënaqur lidhur me mënyrat e përkrahjes në aktivitetet individuale dhe grupore shfaqur në disa trajta siç janë: aspektet kulturore - sportive, iniciativat, edukimi jo-formal dhe infrastrukturën. Trajtim përtej këtyre kornizave u është bërë shkëmbimet kulturore, edukative dhe sportive me vendet e regjionit dhe më gjerë, ku në këtë aspekt të rinjtë shfaqen plotësisht të pa kënaqur me mundësitë dhe hapësirën e dhënë. Aspekti i përfshirjes dhe promovimit merr përmasa edhe më shqetësuese tek të rinjtë që jetojnë në zona rurale ku pjesa më e madhe e tyre ndihen të marginalizuar dhe të përjashtuar.

Duhet theksuar se disa nga komunat kanë bërë hapa në përkrahjen e individëve dhe grupeve që tregojnë suksese të larta në fusha specifike (sport, art, edukim etj). Ku nëpërmjet një buxheti të veçantë janë përcaktuar kuotat për subvencionim (përkrahje).³²

Pavarësisht disa angazhimeve mbetet ende punë e madhe në të menduarit jashtë kornizave, për të gjetur mjete që bëjnë sa më miqësore politikat dhe shërbimet komunale në raport me të rinjtë, duke mos u ndalur vetëm në strukturat ligjore, por duke parë përfshirjen në dizajnimin e politikave edhe familjet e reja dhe grupeve e marginalizuara rinore.

Edukimi: çështja e kualitetit të edukimit qoftë ai formal apo jo formal mbetet brengë e madhe e të rinjve dhe vetë shoqërisë. Ky dimension ka mbetur brenda kornizave të edukimit bazik duke mos arritur të kalohet përtej në edukim kreativ dhe inovativ. Problematik serioze shfaqet edhe tek ndërlidhja e edukimit me tregun e punës, nga anketimet të rinjtë shprehim shqetësimin për mungesën e marrjes së shkathtësive praktike gjatë procesit të edukimit. Në intervistat gjysmë të strukturuar ata theksojnë se kjo çështje duhet të jetë prioritet i institucioneve komunale për shkak se “pas përfundimit të studimeve po kërkohet përvoja e punës 1-2 vite për aplikim për vende pune”.³³

Institucionet qendrore përkatësisht MKRS, ka hartuar dy udhëzues administrativ, i pari ka të bëjë me edukimin jo-formal dhe i dyti me punën vullnetare. Të dyja këto kanë mbetur vetëm në letër dhe nuk po gjejnë zbatim. Andaj, mekanizmat institucional përfshirë komunat, MKRS, institucionet rinore dhe ministritë e linjës duhet ti bëjnë hapat e parë për të shtyrë ndërtimin e një harte të qartë të lidhjes së edukimit me tregun, politikat fiskale dhe përkrahjen e nevojshme për iniciativat individuale dhe grupeve qoftë në ofrimin e edukimit profesional apo përkrahjes nëpërmjet grandeve dhe fondeve të hapura.

³¹ Intervista të gjysmë të strukturuar me të rinjtë e komunave të regjionit të Prishtinës, prill 2016

³² Gerguri Agron, u.d drejtor i DKRS-së – Podujevë; intervistë më datë 23.06.2016

³³ Intervista të gjysmë të strukturuar me të rinjtë e komunave të regjionit të Prishtinës, prill 2016


Marrja e shkathtësive adekuate për tregun e punës del të jetë problem edhe për bizneset vendore³⁴ dhe investitorët potencial. Këtu duhet marrë parasysh edhe tregun e gjere evropian që në vitet vijuese mund të jetë i hapur pas nënshkrimit të Marrëveshjes për Stabilizim dhe Asocim (MSA).³⁵ Ky treg kërkon aftësi dhe shkathtësi konkurrues, të bazuara në standarde evropiane.

Punësimi: në linje edhe me dy aspektet paraprake, punësimi mbetet sfida kryesore, jo gjithnjë vetëm për shkak të vendeve të punës, shpesh të rinjve nuk u ipet e drejta për të aplikuar në konkurse ngase ky institucion është tejmasë i mbyllur dhe arbitrar. Në intervistat gjysmë të strukturuar ekziston një perceptim negativ lidhur me transparencën dhe meritokracinë në konkursat e institucioneve publike dhe private. Shumica prej tyre theksojnë se “përveç, se kërkohet përvoja e punës që nuk kanë ku ta marrim, nuk besoj se përzgjedhja bëhet me merita”. Ata shfaqin mëdyshje se ka edhe ndikime familjare, politike dhe klienteliste.³⁶

Pra problemi i punësimit shpesh shfaqet në një lidhje zigjirore në mes hapësirës, edukimit, shkathtësive dhe përkrahjes. Duhet pasur parasysh këto, ekziston një qasje e përgjithshme se aspektet e punësimit dhe edukimit dominojnë dhe mbivendosen si probleme kryesore duke dalë si barriera edhe për rritjen e pjesëmarrjes, përfshirjes dhe aktiviteteve rinore.

Përgjigjja se a i merre parasysh shqetësimet/interesat e rinisë nga komunat ka korrelacion të drejtë me knaqshmërinë për angazhimin e komunës së tyre lidhur me rininë. Kjo vënë në pah se të rinjtë nuk janë mjaftueshëm të përfshirë në dizajnimin e politikave komunale. Në rastin kur ata do të ishin hisedar, njohja me problemet që ballafaqohet komuna do të rriste në masë kuptueshmërinë, po ashtu politikat e hartuara do të shtyeshin më fuqishëm nga vetë të rinjtë.

Në pyetjen se i marr parasysh komuna interesat/shqetësimet e juaja, 9% shprehen se interesat/shqetësimet e tyre nuk merren parasysh aspak, 29% mendojnë se merren parasysh pak, 26% nuk kanë opinion, 29% mendojnë se merren parasysh mesatarisht dhe 7% mendojnë se interesat/shqetësimet e tyre merren parasysh mjaftueshëm. Shih figurën 7.



³⁴ <http://www.telegrafi.com/eksporti-zhvillon-ekonomine/>

³⁵ http://www.mei-ks.net/repository/docs/1_pkzmsa_miratuar_nga_kuvendi_final_.pdf

³⁶ Intervista të gjysmë të strukturuar me të rinjtë e komunave të regjionit të Prishtinës, prill 2016

Kapitulli IV

Konkluzionet

- *Institucionet kanë ndërmarrë hapa të rëndësishëm në fuqizimin dhe pjesëmarrjen e rinisë, qoftë në aspektin ligjorë, strukturorë, organizativ dhe financiar, megjithatë ekzistojnë ende shumë mangësi në koordinim brenda dhe ndër-institucional;*
- *Ekziston ende një hendek i madh në mes obligimeve të dhëna për komunat dhe institucionet rinore dhe kapacitetet e tyre reale në përmbushjen e këti mandati. Zyrat për Rini, KVRL-të dhe Qendrat Rinore, qëndrojnë keq sa u përket resurseve, hapësirave, programeve rinore dhe përkrahjes financiare;*
- *MKRS, Komunat dhe ministritë e linjës ende nuk kanë arritur ti adresojnë problemet me të cilat përballën të rinjtë nisur nga aktivitetet dhe programet rinore e për të vazhduar deri tek ato më komplekse siç janë punësimi, edukimi dhe promovimi;*
- *Ekziston ende një perceptim negativ sa i përket punës së komunave dhe institucioneve tjera në raport me angazhimin për rini. Po ashtu edhe në raport me atë se debatet publike mund të sillnin një ndryshim qenësorë;*
- *Janë dy probleme bazike (punësimi dhe edukimi cilësorë) të cilat vënë nën hije zhvillimet tjera të politikave rinore, siç janë aktivitetet edukimi-jo formal dhe programet trajnuese;*
- *Ekziston një zbehje e rolit të donatorëve ndërkombëtarë në raport me përkrahjen e rinisë dhe se vakumi i krijuar nuk po arrihet të mbulohet nga institucionet vendore.*
- *Financimi i aktiviteteve rinore ka mbetur barrë e komunave dhe se buxheti i menaxhuar nga DiR – DKRS, nuk garanton zhvillim të barabartë dhe të qëndrueshëm të politikave rinore;*
- *Ende nuk është arritur të ndërtohet një plan i përbashkët nacional i ndër-veprimit në mes komunave, MKRS, ministrive të linjës, institucioneve rinore dhe donatorëve i cili do të ndikonte direkt në dimensionet që prekin të rinjtë;*
- *Programet e shkëmbimit ndërkombëtarë kanë mbetur plotësisht të pa trajtuara, kjo në një masë ka filluar të zbehet edhe me largimin e donatorëve nga fusha e rinisë, kjo pengesë del edhe si pasojë e mungesës së lëvizjes së lirë në BE.*
- *Komunat, ende vazhdojnë që debatet publike ti trajtojnë në rrafshin formal ligjorë, nuk ka praktika dhe evidencë të mjaftueshme të diskutimeve me fokus grupe;*
- *Mekanizmat rinorë, KQVR, KVRL dhe qendrat rinore funksionojnë ende pa hapësira të mjaftueshme, pa kapacitetet profesionale dhe pa përkrahje të mjaftueshme buxhetore;*
- *Të rinjtë nuk ndihen hisedar të politikave komunale dhe nacionale, si pasojë nuk kanë edhe besueshmëri të mjaftueshme në këto institucione;*
- *Ka praktika pozitive në përkrahjen e grupeve të marginalizuara, por ende nuk ka një formë të qartë dhe të mjaftueshme të përkrahjes.*

Rekomandimet

- *Institucionet qendrore, komunat, institucionet rinore dhe donatorët duhet të hartojnë një plan të përbashkët nacional për intervenim urgjent sektorial në përkrahjen dhe fuqizimin e rinisë, duke ndërtuar dhe një koordinim dhe bashkëpunim të vazhdueshëm;*
- *Duhet të hartohet një hartë e qartë e vendim-marrjes dhe ndër-veprimit institucional në mënyrë që plani nacional dhe planet operationale të kenë zbatueshmëri të plotë;*
- *MKRS duhet të gjejë zgjidhje për financimin e aktiviteteve rinore qoftë përmes zbritjes së financave apo ndërtimin e një mekanizmi të pavarur dhe transparent të financimit, në mënyrë që të sigurohet zhvillimi i qëndrueshëm dhe i barabartë;*
- *Udhëzimet administrative për edukim jo-formal dhe vullnetarizmin duhet të marrin qartësinë e plotë në mënyrë që të fillohet me zbatim të efektshëm nga institucionet rinore;*
- *Institucionet qendrore dhe ato lokale duhet ti japin sa më shpejtë zgjidhje ndërlidhjes së edukimit me tregun e punës, duke fuqizuar edhe mekanizmat e aftësisimit profesional dhe orientimit në fushat e specializuara që gjejnë hapësira në treg;*
- *Edukimi formal dhe jo-formal duhet të kthehet nga një proces i të mësuarit didaktik në atë atraktiv dhe inovativ, duke përfshirë dhe praktikën rajonale dhe ndërkombëtare;*
- *Institucionet qendrore/lokale duhet të angazhohen që ti bëjnë të rinjtë hisedar të formulimit dhe zbatimit të politikave në mënyrë që të rritet besueshmëria dhe qëndrueshmëria e politikave.*
- *Debatet publike duhet të kalojnë përtej kornizave ligjore të debateve obligative të përgjithshme në debate të fokusuar, duke i përfshirë të rinjtë që nga dizajnimi e deri tek monitorimi i tyre;*
- *Zyrat për Komunikim me publikun duhet të gjejnë forma më inovative dhe provokuese në mënyrë që të nxitet interesimi i të rinjve për pjesëmarrje;*
- *Institucionet qendrore/lokale duhet të shtojnë transparencën, komunikimin dhe llogaridhënien në mënyrë që të rinjtë të rrisin besueshmërinë në konkurset publike;*
- *Institucionet duhet ta rrisin gamën shërbimeve dhe kategoritë rinore, duke përfshirë në skemat e përkrahjes familjet e reja dhe grupet e marginalizuara;*
- *Institucionet qendrore/lokale duhet të ndërtojnë skema kohezive të përfshirjes së personave me nevoja të veçanta në programet dhe politikat rinore;*
- *Institucionet qendrore/lokale duhet të shtojnë përpjekjet për shtrirjen e aktiviteteve dhe shërbimeve rinore në zonat rurale (fshatra), duke parë mundësitë dhe në investime kapitale;*
- *Përfaqësuesit e zgjedhur (kryetari dhe këshilltarët komunal) me theks asamblistët e rinj duhet të angazhohen në përkrahjen e politikave dhe aktiviteteve rinore;*
- *Komunat duhet që sa më parë ti funksionalizojnë mekanizmat konsultativ dhe profesional të kuvendit në mënyrë që hartimi i rregullativës komunal për rini të marrë dinamika të përshpejtuar.*

